

Në bazë të nenit 182 të Ligjit për arsimin e lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, Statutit të Universitetit të Tetovës dhe nevojës për angazhimin e personave në thirrje të titulluara, shpallet

KONKURS

për zgjedhje të mësimdhënësve në thirrje të titulluara në njësitë e Universitetit të Tetovës

Shpallet konkurs për zgjedhje në thirrje të titulluara në njësitë e Universitetit të Tetovës, si në vijim:

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

1. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Pediatri (30217 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Gjinekologji dhe Akushi (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
3. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Biokimi klinike, Farmakologji klinike me toksikologji (30210, 30211 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
4. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Anatomi, Të tjera (30100, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
5. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Biokimi (biokimi mjekësore), Të tjera (30117 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
6. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Histologji, Të tjera (30101, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
7. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Histologji, Të tjera (30101, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
8. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Onkologji, Të tjera (30220, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
9. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Stomatologji e përgjithshme, Stomatologji preventive, Stomatologji fëmijërore (30400, 30401, 30402 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
10. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Kirurgji maksilofaciale, Traumatologji dento-faciale (30409, 30411 nga

klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

11. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Kirurgji orale (30408 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
12. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Protetikë (30407 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
13. Një mësimdhënës në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar në lëmin Patologji orale, Parodontologji (30405, 30406 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Kandidatët për zgjedhje në thirrje të titulluara duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore në pajtim me nenin 166 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018) dhe kushtet e veçanta të përcaktuara me aktet e përgjithshme të Universitetit të Tetovës.

Plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta kandidatët duhet ta vërtetojnë me dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Fletëparaqitje (merret në Arkivin e Universitetit),
- Diplomë dhe certifikatë të notave për kryerjen e studimeve deridiplomike (origjinal dhe nga një kopje të vërtetuar në noter), diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuara me aktvendim të ministrisë për ekuivalentimin e notave,
- Diplomë dhe certifikatë të notave për kryerjen e studimeve të magjistraturës (origjinal dhe një kopje të vërtetuar në noter), diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuara me aktvendim të ministrisë për ekuivalentimin e notave,
- Diplomë për kryerjen e ciklit të tretë të studimeve – studime të doktoraturës nga fusha shkencore në të cilën bëhet zgjedhja,
- Listë dhe nga një kopje nga punimet e publikuara shkencore,
- Dëshmi për njohje të një nga gjuhët e huaja botërore,
- Biografi e shkurtër,
- Vendim për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore apo shkencore-profesionale (nëse më përpara është zgjedhur në institucion tjetër),
- Dokument me dëshmi për përvojë profesionale (veprimtari mësimore, veprimtari kërkimore-shkencore, veprimtari profesionale-artistike dhe të zbatuar, si dhe veprimtari të interesit më të gjerë) – dokumenti duhet të jetë i sistemuar sipas llojit të veprimtarisë dhe sipas periudhës,
- Certifikatë të shtetësisë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Universiteti i Tetovës